



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e74-të, të mbajtur më 05.09.2022, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi me numër 12-340/1 të datës 25.01.2022, me pretendimet për sekuestrimin e kundërligjshëm të një pjese të pasurisë së paluajtshme, HIDHET POSHTË.

KKPK konstatoi se sipas Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit nuk ka elemente për veprim kompetent në rastin konkret, për arsye se pretendimet në fjalë i referohen shkëlqes së të drejtës individuale në marrëdhëniet pronësore-juridike dhe [01] nuk ka pretendime apo indikacione të qarta për paligjshmëri apo veprime të palejueshme të zyrtarëve në ushtrimin e autorizimeve publike dhe detyrave zyrtare.

Lënda me numër 12-340/1 të datës 25.01.2022 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Nga një parashtrues i njohur më datë 25.01.2022, është dorëzuar denoncim me pretendime për sekuestrim të paligjshëm të një pjese të pasurisë së paluajtshme dhe është formuar lënda me numër 12-340/1 të datës 25.01.2022.

Në denoncim parashtruesi thekson se gjysma e pjesës së trashëguar e pasurisë së paluajtshme i është marrë në mënyrë të paligjshme nga një trashëgimtar tjetër. Testatori i parashtruesit dhe trashëgimlënësi i trashëgimtarit që ka fituar në mënyrë të paligjshme një pjesë të pasurive të paluajtshme kanë lidhur një marrëveshje gojore në vitin 1963 me të cilën kanë ndarë 2/3 e pasurisë, ndërsa gjysma e 1/3 e mbetur në pronësi të trashëgimlënësit të tretë është tjetërsuar nga vendimet në periudhën 1965-1976. Pas vdekjes së trashëgimlënësit të tretë, mbesa e tij nga një vajzë që ishte e punësuar në ----- dhe bashkëshorti i saj që ishte i punësuar në ----- në bashkëpunim me gjyqtarin e atëhershëm ----- nga Gjykata Komunale ----- , duke pasur informacione për zgjerimin e minierës ----- arriti të sekuestronte një pjesë të pasurisë së parashtruesit, pas së cilës prona iu nënshtrua shpronësimi i tokës. Parashtruesi kërkon që

prona e sekuestruar dhe fondet e paguara të kthehen nga -----në bazë të shpronësimit të tokës.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja konstatoi se pretendimet e përfshira në denoncim i referohen shkeljes së të drejtave individuale në marrëdhëniet pronësore-juridike dhe nuk ka pretendime apo indikacione të qarta për veprime të paligjshme apo të palejueshme të personave zyrtarë në ushtrimin e kompetencave publike dhe detyrës zyrtare

Prandaj, KSHPK-ja vlerësoi se nuk ka elemente për veprim kompetent në lëndë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar deri te:
Parashtruesi i denoncimit

Përgatiti: B.K.SH

KOMISIONI SHETËTORË
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
Kryetare,
Biljana Ivanovska

